



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 543, Datë 20.09.2018

“Për mos klasifikim si përqendrim të njoftimit për transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi për shitjen dhe transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, 15, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve për njoftimin e përqendrimit mbi shitjen dhe transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A.

VËREN SE :

1. Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me “Marrëveshjen Kuadër” midis Comdata S.p.A. dhe Sestante Holding SRL për blerjen e 85% të kuotave të CC Tirana SHPK, me shkresën nr. 330, datë 23/05/2018 (protokolluar pranë AK) marrëveshje e lidhur më datë XXX 2018 ndërmjet palëve Comdata S.p.A. dhe Sestante Holding SRL.

Blerësi: COMDATA S.p.A është një shoqëri aksionare italiane e cila kontrollohet nga Carlyle Europe Partners IV L.P.UK. Comdata S.p.A ofron shërbime “outsourcing” të

proceseve të biznesit lidhur me zgjidhjet e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët. Shërbimet e saj mbulojnë shërbime në fushën e analizës, back office, këshillimit, qendrave të kontaktit, menaxhimit të kredisë dhe shërbimeve të teknologjisë. Comdata S.p.A. aktualisht nuk operon në Shqipëri.

Shitësi: Sestante Holding SRL, një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, në mars 2005. Objekti i veprimtarisë së saj është mbështetje dhe asistencë teknike, për shoqëritë profesionale, gjatë administrimit dhe vendimmarrjes organizative. Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Agron Shehaj.

Shoqëria Sestante Holding SRL, sipas dokumentacionit të paraqitur pranë AK, është 100% ortake e vetme në Shoqërinë CC Tirana SHPK, e cila është shoqëria target e këtij transaksioni.

Shoqëria target: CC Tirana SHPK me aksionar 100% shoqërinë Sestante Holding Srl, është regjistruar në QKB më 05.04.2018, dhe objekti i veprimtarisë së saj është: ofrimi i të gjitha shërbimeve që lidhen me Call Centre dhe Contact Center dhe aktivitet “Back Office”, në fushën e kujdesit ndaj klientit, tele-marketingut apo tele-selling (shitjeve nëpërmjet telefonit) inbound dhe outbound duke përfshirë gjithashtu edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera dhe/ose enteve publike.

Nëpërmjet njoftimit të këtij transaksioni pranë AK, Shoqëria blerëse COMDATA S.p.A., synon të blejë 85% të kapitalit të Shoqërisë CC Tirana SHPK.

Nga të dhënat e dorëzuara pranë AK, rezulton se xhiroja e aktivitetit të shoqërisë CC Tirana SHPK, për vitin 2018, është në vlerën 0 (zero) lekë.

Në zbatim të neneve 10, pika 1, gërma b), nenit 12, pika 1, gërma a), dhe nenit 15, pika 2, që të ndodhemi përpara një përqendrimi duhet që jo vetëm të përfitohet kontrolli i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga një ose më shumë ndërmarrje përmes blerjes së kuotave, por edhe xhiroja e ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duhet të jetë 7 miliardë lekë në tregun ndërkombëtar dhe xhiroja e ndërmarrjes pjesëmarrëse në tregun e brendshëm duhet të jetë 200 milion lekë, por siç u evidentua më sipër xhiroja e aktivitetit të shoqërisë target CC Tirana SHPK, për vitin 2018, është në vlerën 0 (zero) lekë.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar pranë AK, në kuptim të ligjit 9121/2003, nuk përbën përqendrim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë njoftimin “Për transferimin e 85% të kuotave të shoqërisë CC TIRANA SHPK tek COMDATA S.p.A”, si përqendrim, pasi ai nuk përmbush kushtet ligjore në zbatim të neneve 10, 12 dhe 15 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS